



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

V E N D I M

nr. 404, datë 1.03.2016

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.373, datë 16.09.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar””

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Zv/Kryetar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAJMI Anëtar
- Eduard YPI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 1. 03.2016, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shtyrja e afatit në lidhje me hetimin e përgjithshëm në sektorin bankar.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d); neni 41, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2016 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);

Ligji nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”;

Komisioni i Konkurrencës pasi mori në shqyrtim relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm për një ndryshim në Vendimin nr 373, datë 16.09.2015 për hapjen e hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar,

V Ë R E N S E:

1. Nëpërmjet Vendimit nr. 373, datë 16.09.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar”, Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 41 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), ka miratuar hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar.
2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ngriti grupin e punës përgjegjës për ndjekjen e procedurave

hetimore.

3. Në zbatim të nenit 41, pikat 2 dhe 4, me qëllim sigurimin e informacionit të nevojshëm për kryerjen e hetimit dhe vlerësimin e konkurrencës në treg, është kërkuar informacion nga subjektet që operojnë në këtë treg, nga Banka e Shqipërisë dhe Shoqata Shqiptare e Bankave.
4. Për arsye objektive disa prej këtyre ndërmarrjeve kanë kërkuar shtyrjen e afatit për sjelljen e të dhënave dhe informacionit të kërkuar në mënyrë të plotë sipas kërkesave të Sekretariatit duke bërë të pamundur përpunimin e tyre, kryerjen e analizave statistikore - ekonomike dhe hartimin e raportit brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 373, datë 16.09.2015, pika III.
5. Për vetë rëndësinë e rastit, siguri i një informacioni të plotë është i domosdoshëm për të siguruar një vendim-marrje objektive të Komisionit të Konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 41, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2016 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Ligjit nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin nr. 373, datë 16.09.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar”, pika III të ndryshohet si vijon:
 - a. Procedura e hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar dhe dorëzimi i raportit të hetimit të bëhet jo më vonë se data 31 Maj 2016.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Iva Zajmi

Eduard YPI

(_____)

Zv.Kryetar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R